Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	departamenti. ²⁴² Pas miratimit, çdo lektor udhëheqës i komunikon studentit me email ²⁴³ që ai do e udhëheq dhe që në këtë moment <i>Udhëheqësi</i> i diplomës orienton dhe ndihmon studentin që në përcaktimin e temës së punimit të diplomës dhe në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.			
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Po. Institucioni asiston studentët për kryerjen e detyrave të kursit dhe në punimin e temës së diplomës duke i vendosur në dispozicion laboratorët dhe bibliotekat (online dhe fizikisht) ²⁴⁴²⁴⁵²⁴⁶²⁴⁷²⁴⁸ . Në këtë mënyrë njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. ²⁴⁹			
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Po. Sipas rregullores së shlyerjeve të detyrimeve përmbyllëse, aneksi 1, modeli 1 shpalljes së rezultateve të provimit përfundimtar dhe Kreu 3, Neni 2, pika 5 studenti diplomohet duke mbrojtur temën e diplomës përpara një komisioni dhe vlerësohet me notë. ²⁵⁰			
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Po. Referuar rregullores së shlyerjeve të detyrimeve përmbyllëse, Kreu 2, Neni 6, pika 8, studentët që kalojnë me sukses temën e diplomës apo provimin e përgjithshëm përfundimtar të diplomimit pajisen me diplomën përkatëse në përputhje me parashikimet e pikes 1, gërma c) të Nenit 67 të rregullores së Fakultetit të Biznesit. Gjithashtu në Rregulloren e Sekretarisë për Fakultetin e Biznesit në Nenin 23 dhe Nenin 24 shprehet se një ndër detyrat e institucionit është që në përfundim të studimeve, student të pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. ²⁵¹ Në përfundim të studimeve, studentit njoftohen për tërheqjen e diplomës dhe suplementit.			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Po. Institucioni e ka të detyrueshme të ruajë dhe arkivojë sipas një afati të caktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, informacione për studentët nëse kërkohen. ²⁵²			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

²⁴² Evidencë 159. Ngritje komisioni Ad Hoc për vlerësim provim diplomë departamenti Finance-Kontabilitet

²⁴³ Evidencë 150. Email për udhëheqjet e temave të diplomës

²⁴⁴ Evidencë 133. Rregullorja e Bibliotekës

²⁴⁵ Evidencë 134. Marrëveshjet e bibliotekës për të përdorur aksesin elektronik JStore.

²⁴⁶ Evidencë 135. Të dhënat për bibliotekën

²⁴⁷ Evidencë 136. Të dhëna për platformat on-line- Biblioteka

²⁴⁸ Evidencë 132. Liste E-books të disponueshme për përdorim

²⁴⁹ Evidencë 109. Shkrese për laboratorin e Doktoraturës. Raporti për AKKSHI për laboratorin e doktoratës

²⁵⁰ Evidencë 150. Email për udhëheqjet e temave të diplomës

²⁵¹ Evidencë 151. Suplementet e diplomave Bsc FK_2018 dhe 2020

²⁵² Evidencë 118. Rregullore e Sekretarisë Mësimore FB

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Po. Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit Bachelor në Financë- Kontabilitet, i përmbush kërkesat ligjore, të përcaktuara në Ligjin për arsimin e lartë, Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij²⁵³, kriteret e shpallura në departament për rekrutimet për lektorë me kohë të pjesshme. Në departamentin Financë-Kontabilitet janë 16 lektorë efektiv, ku kualifikimi i tyre është i shpërndarë sipas të dhënave statistikore “Tituj dhe Grada”, viti 2018-2023²⁵⁴. Arsimitimi i lektorëve të departamentit Financë-Kontabilitet dhe rritja e tyre akademike në tituj dhe grada janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve që ata mbulojnë²⁵⁵. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit Bsc. Financë- Kontabilitet referuar fushës së studimit të tyre në Dosjet e Vetëvlerësimit²⁵⁶ dhe në CV e rifreskuara²⁵⁷ janë në përputhje me programin e studimit²⁵⁸, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij dhe fushat e kërkimit shkencor të DEP. FK²⁵⁹. Secili lektor mundohet të jetë gjithmonë i përditësuar me legjislacionet e fundit dhe me të rejat e fundit në lëndën që mbulon, duke i sjellë studentëve materiale dhe leksione si në aspektin teorik por edhe në atë praktik.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Po. Udhëzimi 29 i datës 10.09.2018 i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit përcakton ngarkesën mësimore të personelit akademik efektiv në IAL në bazë të kategorive të ndryshme. Personeli akademik efektiv i angazhuar në programin e studimit Bachelor Financë- Kontabilitet mbulon ngarkesën mësimore bazuar në kornizën ligjore në fuqi.²⁶⁰²⁶¹, referuar edhe ngarkesës mësimore deklaruar në Departament F-K²⁶². Në bazë të legjislacionit në fuqi lektori brendshëm mbulon ngarkesën e tij prej 195 orë si dhe lektorët e jashtëm prej 120 orë. Gjithashtu lektorët bëjnë edhe marrëveshje për organizimin e kohës vjetore të punës²⁶³.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe</p>	<p>Po. Marrëdhënia e punësimit në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës rregullohet nëpërmjet kontratës së punësimit si edhe personeli akademik i angazhuar mbulohet me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.²⁶⁴ Sipas kategorisë së ndarjes së lektorëve me tituj MSC/ Doktoraturë apo Kategoria Profesor. Programi i studimit Bachelor Financë-Kontabilitet mbulohet nga një staf me eksperiencë akademike mbi 10 vjet²⁶⁵. Çdo muaj Drejtoria e Shërbimeve Financiare e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës i përcjell me e-mail raportimin e pagës personelit akademik ku janë të detajuara dhe</p>

²⁵³ Evidencë 20. Ligji nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institutet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”

²⁵⁴ Evidencë 86. Personeli akademik i njësisë kryesore me tituj dhe grada

²⁵⁵ Evidencë 88. Short Bio të stafit akademik dep FK, bachelor FK

²⁵⁶ Evidencë 89. Dosje të vetvlerësimit të stafit akademik dep FK, bachelor FK

²⁵⁷ Evidencë 98. CV të stafit akademik dep FK, bachelor FK

²⁵⁸ Evidencë 106. Përputhja e Formimit me angazhimin për personelin akademik F-K

²⁵⁹ Evidencë 90. Fushat kërkimore të dep. FK për ciklin 1.2.3, 25.01.2022

²⁶⁰ Evidencë 91. Udhëzimi-nr. 29-dt-10.9.2018_Ngarkesa e Personelit Akademik

²⁶¹ Evidencë 92. Ngarkesa departamentit 2020-2022

²⁶² Evidencë 92. Ngarkesa departamentit 2020-2022

²⁶³ Evidencë 115. Marrëveshje për organizimin e kohës vjetore të punës për personelin akademik.

²⁶⁴ Evidencë 94.1 Model Kontrate Pune - UAMD

²⁶⁵ Evidencë 82. Analiza Vjetore Departamenti Financë - Kontabilitet

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	sigurimet shoqërore dhe shëndetësore si dhe orët suplementare në rastet e tejkalimit të ngarkesës së detyrueshme. ²⁶⁶
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Po. UAMD rekruton personel akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ në përputhshmëri të plotë me Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” (nenet 64-67), Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, Rregulloren e UAMD dhe Statutin e UAMD ²⁶⁷ . Në varësi të strukturës së miratuar me anë të Vendimit të Këshillit të Administrimit nr. 30, datë 31.05.2018 “Për miratimin e strukturës së përgjithshme të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës”, Njësia Bazë përcakton kriteret që duhet të përmbushen nga aplikanti. Këto kritere i përcillen Drejtuesit të Njësisë Kryesore, i cili pasi i miraton ia përcjell Rektorit. ²⁶⁸ Mbi bazën kritereve të miratuara nga njësia bazë ²⁶⁹²⁷⁰ , shpallet konkurs i hapur “Për vendet të lira të punës për personel akademik me kohë të plotë” (ose të pjesshme) dhe kryhet publikimi në Buletin e Njoftimeve Publike pranë Agjencisë së Prokurimeve Publike, në formë të shkruar dhe elektronike. Gjithashtu njoftimet publikohen edhe në faqen zyrtare të UAMD. ²⁷¹ Për procedurën e rekrutimit ngrihet Komisioni Ad-Hoc ²⁷² . Procesii shpalljes së fituesve bëhet nëpërmjet procedurës së shqyrtimit të dosjes dhe intervistave duke ju referuar kritereve të shpallura në Dep. FK.
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Po. Personeli ndihmës akademik i Fakultetit të Biznesit është i përbërë nga sekretaria e ciklit të parë bachelor, asistentja e departamentit dhe dy laborantë ²⁷³ , të cilët ofron suport për veprimarinë mësimore të stafit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. Ky personel ka kualifikimin e duhur dhe i përshtatet nevojave dhe natyrës specifike të programit të studimit. Lektorëve përmes sallës së laboratorit i vijnë në ndihmë softweret e rëndësishme të antiplagjiaturës edhe programet e periprazimit apo te gramatikës të cila janë të domosdoshme për kërkim shkencor dhe përmes tyre at kanë mundësi të realizojnë një rritje në karriere duke finalizuar publikime në revista shkencore dhe duke marrë pjesë nëpër konferenca.
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Po. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Dega e Burimeve Njerëzore në bazë të nenit 24 në Statutin ²⁷⁴ e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës është përgjegjëse për përditësimin e dosjeve të stafit akademik me kohë të plotë, personelit ndihmës akademik dhe administrativ duke e vënë informacionin në dispozicion të njësive bazë. Çdo vit akademik personeli akademik plotëson formularët e vetëvlerësimit ku pasqyrohet progresi shkencor dhe akademik mbi të cilin bëhet vlerësimi i performancës nga Drejtuesi i Njësisë Bazë dhe Njësia Kryesore. Të dhënat për angazhimin e stafit akademik në programin e studimit gjenden edhe në analizën vjetore të DEP. FK (ngarkesa mësimor). ²⁷⁵ Gjithashtu “Baza e të dhënave të Kërkimit Shkencor” mundëson monitorimin në kohë reale të aktivitetit të kërkimit shkencor duke mundësuar një vlerësim periodik dhe një rankim në kohë reale të tij. Ky rankim bëhet në nivel kombëtar (sipas fushave) përmes portalit “Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore shkencore”, në platformën ACRIS (Sistemi shqiptar i informacionit të kërkimit shkencor) që administrohet nga RASH-i ²⁷⁶ . Gjithashtu lektorët testohen edhe duke i bërë anketime studentëve rreth procesit të mësimdhënies, rreth aftësisë së lektorit,

²⁶⁶ Evidencë 94. Raportimi mujor i pagës

²⁶⁷ Evidencë 8. Rregullore UAMD, Statuti UAMD

²⁶⁸ Evidencë 95. Rregullore e brendshme e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike

²⁶⁹ Evidencë 96. Kriteret e miratuara në departamentin FK për rekrutimin e stafit të brendshëm

²⁷⁰ Evidencë 97. Relacion rekrutimi lektoresh me kohe te pjesshme 2020-2021 dhe 2021-2022 Dep FK

²⁷¹ Evidencë 100. Procedura për Rekrutime, linku punësime te faqja e UAMD. <https://uamd.edu.al/mundesi-punesimi/>

²⁷² Evidencë 101. Komisioni Ad Hoc per Rekrutime lektore PT

²⁷³ Evidencë 14. Organigrama e Universitetit Aleksandër Moisiu – kërko organigramën e përditësuar

²⁷⁴ Evidencë 6. Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës

²⁷⁵ Evidencë 82. Analiza Vjetore Departamenti Financë - Kontabilitet

²⁷⁶ Evidencë 121. Faqja zyrtare e kërkimit shkencor, <https://kerkimi-shkencor.rash.al/>

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43123

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	rreth mënyrës së shpjegimit të tij dhe mbi korrektesën e lektorit gjatë semestrit akademik.			
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Po. Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Financë-kontabilitetit kanë marrëveshje me IAL dhe organizata biznesi. Studentët kanë në dispozicion Drejtorinë e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike që ka nën varësi Sektorin e Karrierës dhe të Alumnit, ku Neni 15 i rregullores së kësaj Drejtorie përcakton funksionimin e Sektorit të Karrierës dhe Alumni dhe shërbimeve që ajo ofron për studentët në procesin e praktikës dhe punësimit. ²⁷⁷ Në rregulloren e detyrimeve përmblylëse përcaktohet udhëheqësi dhe përgjegjësit e udhëheqësit të diplomës. ²⁷⁸ Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi ²⁷⁹ me IAL të tjera, përfaqësues biznesi dhe kompani, të cilat lehtësojnë zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve para diplomimit të tyre. Gjithashtu marrëveshje bashkëpunimi ka edhe fakulteti për programet e tij të studimit në mënyrë që t’i ofrojë studentëve mundësi punësimi pas diplomimit të tyre, në fushën e kontabilitetit ²⁸⁰ .			
Kriteri 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritis që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Po. Procesi i praktikës mësimore për studentët bachelor në bazë të ndryshimeve të bëra në kurikulat ekzistuese, është parashikuar të realizohet në vitet e ardhshme sepse nuk ka qenë e parashikuar për vitin aktual dhe vitet e mëparshme. Ajo do të zhvillohet mbështetur në Rregulloren së Praktikës Mësimore dhe në sajë të bashkëpunimeve me institucionet me të cilat UAMD ²⁸¹ dhe FB ka marrëveshje bashkëpunimi. ²⁸² Referuar rregullores, lektorët bëjnë dhe vlerësimin e studentit ²⁸³ dhe vlerësimi përfundimtar bëhet para komisionit ²⁸⁴ . Vlerësimi i bërë nga lektori udhëheqës është i pavarur nga vlerësimi i bërë nga komisioni në fund në mënyrë që të kemi një vlerësim sa më të drejtë të studentit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Po. Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Procesi mësimor zhvillohet në tre godina, një në Currila dhe dy në Kampusin Universitar, Spitalë duke krijuar kushtet e nevojshme, të përshtatshme dhe të barabarta për zhvillimin e veprimtarisë mësimore.</p> <p>Fakulteti i Biznesit e zhvillon procesin mësimor dhe veprimtarinë akademike në Godinën Nr.2 të Kampusit Universitar, Spitalë. Në këtë godinë disponohen mjediset e mjaftueshme mësimore: 15 auditorë, 2 laboratorë, bibliotekën dhe sallën e</p>

²⁷⁷ Evidencë 103. Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike

²⁷⁸ Evidencë 36. Rregullore e detyrimeve përmblylëse për ciklin e parë të studimeve bachelor FK, në FB

²⁷⁹ Evidencë 24. Lista e marrëveshjeve në nivel Institucional të UAMD

²⁸⁰ Evidencë 69. Marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel Fakulteti

²⁸¹ Evidencë 24. Lista e marrëveshjeve në nivel Institucional të UAMD

²⁸² Evidencë 69. Marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel Fakulteti

²⁸³ Evidencë 105. Formulari i vlerësimit të lektorit udhëheqës

²⁸⁴ Evidencë 116. Formulari i vlerësimit të komisionit

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	konferencave të cilat janë të dispozicion të procesit të mësimdhënies dhe studimit për të garantuar veprimtarinë mësimore të programit të studimit. ²⁸⁵²⁸⁶			
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Po. Mjediset mësimore dhe laboratorike ²⁸⁷ në Fakultetin e Biznesit, që ndodhen në godinën Nr.2 të Kampusit Universitar në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, janë të pajisuara me të gjitha pajisjet e nevojshme teknologjike dhe digjitale që janë të nevojshme për procesin e mësimdhënies dhe mësim nxënies. Të gjitha klasat janë të pajisura me tabela whiteboard dhe mundësi për videoprojektor të lëvizshëm (dhe të montuar), të cilat mundësojnë zhvillimin e mësimin në kushte bashkëkohore. Zyrat e personelit akademik dhe administrativ që gjenden në këtë godinë, janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme (kompjuter, printer, tavolinë pune, dollap etj) Laboratorët janë të përshtatshëm për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit dhe përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve. ²⁸⁸			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Po. Laboratorët e Fakultetit të Biznesit plotësojnë nevojat e studentëve të programit Bachelor Financë- Kontabilitet duke i ofruar pajisjet e duhura teknologjike dhe digjitale në mënyrë që të plotësohen nevojat e tyre për studim dhe kërkim shkencor. Dy laboratorë janë në funksion të Fakultetit të Biznesit për studentët master, të cilët përfshijnë gjithsej 80 vende me një sipërfaqe 134.4 m ² . Laboratorët janë të pajisur me programe standarte por edhe specifike si Financa 5, Eviews, SPSS të cilat plotësojnë nevojat e studentëve për studim dhe kërkim shkencor. ²⁸⁹ Gjithashtu Fakultetit të Biznesit I është shtuar dhe laboratorit I Doktoraturës I cili është I pajisur me software e fundit si Eviews/ SPSS/ program Antiplagjiaturë/ Grammarly etj ²⁹⁰²⁹¹ . Gjithashtu sallat e leksioneve dhe laboratorët e disponueshëm janë të pajisur me pajisjet e domosdoshme për zhvillimin normal të orëve mësimore ²⁹² .			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Po. Institucioni me kapacitetet që zotëron garanton, infrastrukturën e mjaftueshme për zhvillimin e praktikave laboratorike. Fakultetit të Biznesit ka dy laboratorë që janë në funksion të studentëve të bachelor FK me gjithsej 80 vende me një sipërfaqe 134.4 m ² . Laboratorët janë të pajisur me programe standarte por edhe specifike si Financa 5 për plotësimin e nevojave të studentëve për studim dhe kërkim shkencor ²⁹³ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe	Po. Në çdo fillim semestri studentët e programit të studimit Bachelor Financë-Kontabilitet, njihen me literaturën bazë dhe ndihmëse të kërkuar për realizimin me sukses të procesit mësimor, sikurse është parashikuar në syllabuset e lëndëve. Kjo literaturë është vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit nga personeli akademik duke garantuar marrjen e dijeve dhe njohurive të

²⁸⁵ Evidencë 107. Infrastruktura, pika 7 ne SHTOJCA 1 udhezimi 31 TIP per Msc ISDR

²⁸⁶ Evidencë 122. Raport Vjetor i veprimtarise mesimore kerkimore shkencore dhe financiare per v.a. 2021-2022

²⁸⁷ Evidencë 175. Te dhena per Fakultetin e Biznesit

²⁸⁸ Evidencë 108. Informacion mbi pajisjet hardware dhe software në FB.

²⁸⁹ Evidencë 108. Informacion mbi pajisjet hardware dhe software në FB.

²⁹⁰ Evidencë 109. Shkrese për laboratorin e Doktoraturës. Raporti per AKKSHI per laboratorin e doktoratures

²⁹¹ Evidencë 58. Laboratori Doktoratures

²⁹² Evidencë 108. Informacion mbi pajisjet hardware dhe software në FB.

²⁹³ Evidencë 107. Infrastruktura, pika 7 ne SHTOJCA 1 udhezimi 31 TIP per Msc ISDR

<p>njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. Literatura bazë për çdo lëndë që ofrohet në këtë program studimi është në gjuhën shqipe dhe angleze.²⁹⁴ Biblioteka Shkencore e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës siguron literaturën bazë dhe ndihmëse nëpërmjet ofrimit të sallës me fond të hapur me literaturë referenciale, periodike, literaturë prej burimeve elektronike të bibliotekës, literaturë me burime elektronike të huaja. Literatura e vënë në dispozicionin e studentëve mbështet nevojat e tyre mësimore dhe të kërkimit shkencor. Biblioteka disponon gjithashtu edhe një fond të mbyllur. 80% e literaturës së vënë në dispozicion është e 5-7 viteve të fundit dhe nga shtëpitë botuese të mirënjohura ndërkombëtarisht. Mbështetur në nenin 38 të Rregullores së Shërbimeve Akademike²⁹⁵ studentët nëpërmjet Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) kanë akses në platformën U-Albania dhe përmes AADF-së kanë akses edhe në JSTOR drejtpërdrejt nga sistemi pitagora në të cilin ata aksesojnë për të bërë regjistrimin e lëndëve dhe njëkohësisht mund të ndërhyjnë për të shkarkuar apo lexuar material apo punime shitesë në JSTOR. Literatura bazë është e mbledhur edhe në listën e titujve në Bibliotekë për programin e studimit.²⁹⁶ Biblioteka qëndron e hapur çdo ditë dhe studentët janë të lirë të shkojnë qoftë për të lexuar, ose për të marrë literaturë të ndryshme me të drejtë rikthimi.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Po. Biblioteka e UAMD kryen periodikisht blerje për Institucionin nëpërmjet donatorëve të huaj, të cilët sigurojnë botime në mënyrë fizike dhe elektronike²⁹⁷. Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, bën vazhdimisht përpjekje për realizimin e kërkesave për blerje librash për njësitë bazë, në varësi të nevojave për pasurimin e fondeve por dhe përditësimin e literaturës e cila pasqyrohet në syllabuset e lëndëve duke kontribuar në cilësinë e mësimdhënies²⁹⁸. Lektorët e kanë të detyrueshme që të dorëzojnë një kopje të lekoneve apo literaturës që mund të kenë botuar personalisht, ose të literaturave që disponon syllabusi i çdo lektori.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Po. UAMD vë në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik bibliotekën mësimore e cila mundëson jo vetëm ambiente studimi por edhe ambiente sociale si edhe ambiente të cilat mund të shfrytëzohen nga studentët dhe kërkues për promovimin e veprimtarisë dhe aktiviteteve të ndryshme hulumtuese si edhe garanton ofrimin e shërbimeve për një akses të hapur. Sipas nenit 32 të Rregullores së Drejtorisë së Administrimit të Shërbimeve Akademike përdorues i bibliotekës është personi juridik ose fizik që paraqet një kërkesë me shkrim ose jo për të përfituar falas ose sipas tarifave të miraturara një shërbim që ofrohet nga Biblioteka e UAMD.²⁹⁹ Studentëve i është në dispozicion dhe dy bibliotekat online JSTOR³⁰⁰ dhe Ebsco³⁰¹.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Po. Në nenin 39 të Rregullores së Drejtorisë së Administrimit të Shërbimeve Akademike, specifikohet që Biblioteka Universitare e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës ka abonim në 30 revista shkencore, kryesisht në anglisht, italisht dhe gjermanisht, 600 tituj libra akademik në gjuhë të ndryshme, akses në periodikun shqip të periudhës 1945-2007, literaturë në gjuhë të huaj, revista³⁰², gazeta, fjalorë dhe enciklopedi, arshivën akademike, arshivën digjitale. Institucioni vë në dispozicion gjithashtu edhe Listën e Paketave që përfshihen në U-LIBRARY dhe j-stor.org³⁰³. Duke u bazuar në relacionin e bibliotekës gjegjë të evidentuara të gjitha të dhënat për bibliotekën³⁰⁴ me abonimet dhe shërbimet që ajo ofron. Biblioteka ofron edhe një listë</p>

²⁹⁴ Evidencë 111. Model Syllabusi v.a 2021-2022 Financat Personale

²⁹⁵ Evidencë 103. Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike

²⁹⁶ Evidencë 112. Relacion për aktivitetin e Bibliotekës së UAMD

²⁹⁷ Evidencë 112. Relacion për aktivitetin e Bibliotekës së UAMD

²⁹⁸ Evidencë 110. Model Syllabusi në Bachelor FK Baza Finance V.A. 2022-2023

²⁹⁹ Evidencë 103. Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike

³⁰⁰ Evidencë 134. Marrëveshjet e bibliotekës për të përdorur aksesin elektronik JStore.

³⁰¹ Evidencë 112. Relacion për aktivitetin e Bibliotekës së UAMD

³⁰² Evidencë 103. Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike

³⁰³ Evidencë 112. Relacion për aktivitetin e Bibliotekës së UAMD

³⁰⁴ Evidencë 135. Të dhënat për bibliotekën





	tekstesh ndërkombëtare të shkarkueshme nga JStor që i vihen në dispozicion të gjithë studentëve dhe lektorëve ³⁰⁵ .
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Po. Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës garanton akses të plotë pa pagesë në paketën U-LIBRARY për të gjithë studentët si dhe j-stor.org në të cilat ka një shumëllojshmëri literature për studentët e programit të studimit Bachelor FK. Në dispozicion të studentëve janë edhe sistemi KOHA ³⁰⁶ dhe COBISS. Studentët kanë gjithashtu në dispozicion edhe një manual të përdorimit të Bibliotekës online. ³⁰⁷ Sistemi “KOHA” është një databazë e krijuar nga biblioteka e UAMD-së dhe ndihmon përdoruesit të shkarkojnë libra, artikuj shkencor, disertacione, etj, pa limit kohor përdorimi. COBISS+ është krijuar për të gjithë përdoruesit: kërkuesit shkencorë, nxënësit, studentët, prindërit, profesorët, pensionistët, etj, për të gjithë ata, që kërkojnë informacione dhe materiale (edhe ato elektronike), të cilat janë në dispozicion në bibliotekat e Shqipërisë. Aktualisht, me iniciativë të Dep. F-K, UAMD, është në periudhë testimi për një marrëveshje bashkëpunimi për aksesim pa pagesë në platformën universitare “Coursera”, e cila mundëson 4.000 kurse ndërkombëtare online me mbi 200 universitete të huaja partnere, 71 milion përdorues, 500 kompani prestigjioze ndërkombëtare dhe shumë qeveri në mbarë globin ³⁰⁸ .
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Po. Salla me fond të hapur ofron të gjitha facilitetet digjitale në formën hardware apo software për të lehtësuar veprimtarinë kërkuese dhe studimore të të gjithë studentëve të programit të studimit, e cituar kjo edhe në neni 39 të Rregullores së Drejtorisë së Administrimit të Shërbimeve Akademike. ³⁰⁹ Biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve ^{310,311} . Studentët kanë mundësi që përmes pajisjeve që ofron biblioteka të aksesojnë në programe të ndryshme kompjuterike si dhe të shkarkojnë literaturë të ndryshme për ti përdorur në ndihmë të studimit dhe kërkimit për arritje sa më efektive.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Po. Oraret e shërbimit të Bibliotekës janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesimit mësimor. Biblioteka ka orare të përshtatshme me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve. Për ti ardhur në ndihmë studentëve biblioteka është e hapur edhe në fundjavë duke siguruar shërbim të pandërprerë për përdoruesit e saj. ³¹² Gjithashtu biblioteka ka një rregullore të saj e cila duhet të zbatohet nga frekuentuesit e saj ³¹³ .
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik	Po. Njësia bazë, Departamenti i Financë- kontabilitetit, përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Financë- Kontabilitet ndjek dhe raporton nevojat për fondin fizik dhe fondin online të programit të studimit në bashkëpunim me bibliotekën në mënyrë që të përmbushen nevojat e studentëve të programit të studimit. Vlerësimi dhe zhvillimi i pasurisë akademike, kulturore dhe shkencore realizohet nëpërmjet politikave në nivel Universiteti duke evidentuar numrin e frekuentuesve në bibliotekë, frekuencës së përdorimit të titujve, cilësinë e revistave, në të cilat botohen artikujt shkencorë të stafit akademik, vizitorët që frekuentojnë bibliotekën, citimet e punimeve shkencore të stafit akademik të UAMD. Njësia bazë, Departamenti i Financë- kontabilitetit, përgjegjëse për programin e studimit Bachelor Financë- Kontabilitet ndjek dhe raporton nevojat për fondin fizik dhe fondin online të programit të studimit në bashkëpunim me bibliotekën në mënyrë që të përmbushen

³⁰⁵ Evidencë 132. Liste E-books te disponueshme për përdorim.

³⁰⁶ Evidencë 136. Të dhëna për platformat on-line- Biblioteka

³⁰⁷ Evidencë 112. Relacion për aktivitetin e Bibliotekës së UAMD

³⁰⁸ Evidencë 120. Faqja zyrtare per kurset falas ne coursera dhe faqe te tjera ne bashkëpunim me UAMD
<https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/2021/07/05/ndiq-nje-kurs-falas-ne-coursera-dhe-zhvillo-karrieren-tende/>

³⁰⁹ Evidencë 103. Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike

³¹⁰ Evidencë 112. Relacion për aktivitetin e Bibliotekës së UAMD

³¹¹ Evidencë 135. Të dhënat për bibliotekën

³¹² Evidencë 114. Kalendari i Funkcionimit të Bibliotekës në fundjavë

³¹³ Evidencë 133. Rregullorja e Bibliotekës

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	nevojat e studentëve të programit të studimit. Çdo vit akademik parashikohen fonde për blerjen e literaturës shkencore. ³¹⁴³¹⁵			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Po. Sistemi I Menaxhimit të institucionit realizohet nëpërmjet Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike neni 30 ³¹⁶ , Sekretaria e Fakultetit të Biznesit (sipas Rregullores) ³¹⁷ dhe sistemit Pitagora (RASH) ³¹⁸ . Ky sistem aplikohet për studentët e ciklit të parë të studimeve në bazë të marrëveshjes që institucioni ka me dhe me implementimin dhe përdorimin e kësaj platforme ³¹⁹ . Drejtori të tjera në administrim të informacionit janë Zyra e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe IT, Drejtorja e Edukimit: Kurrikula dhe shërbimi ndaj studentëve dhe Zyra e Karrierës, Alumni. Pjesë e rëndësishme e sistemit të menaxhimit të informacionit në lidhje me studentët përbëhet nga Sekretariatë mësimore në çdo fakultet dhe sistemet elektorike. Funksionet e Sekretarisë mësimore për Fakultetin e Biznesit janë të përcaktuara në rregulloren e Fakultetit të Biznesit ³²⁰ .
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Po. Njësia bazë si edhe struktura e Burimeve njerëzore ³²¹ menaxhojnë dhe administrojnë dokumentacionin për stafin akademik dhe ndihmësakademik dhe partnerët e angazhuar në programin e ciklit të parë të studimeve. Informacioni përditësohet pranë Njesisë bazë nëpërmjet përditësimit të CV ³²² (kualifikimeve), dosjeve të përvitshme të vetëvlerësimit ³²³ , vlerësimit të kërkimit shkencor të nxjerra nga raportet e kërkimit shkencor në rang universiteti ³²⁴ dhe në rang fakulteti ³²⁵ . Drejtuesi I Njesisë bazë shpërndan informacionin me kordinatorin e programit të studimit, me stafin ndihmësakademik dhe me Dekanatin.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Po. Fakulteti i Biznesit dhe Dep. Financë-Kontabilitet disponojnë për secilin semestër të vitit akademik, listën e plotë të personelit akademik të përfshirë në programin e studimit sipas orareve të miratuara ³²⁶ . Përpara fillimit të orës mësimore, Çdo lector i angazhuar në mësimdhënie pajiset me rregjistrin (të cilin e merr çdo fillim ore) dhe firmos listë-prezencën, e cila shërben si element për kontrollin e praninë e lektorëve gjatë orës së mësimi. Regjisitri dorëzohet përsëri në sekretari, procedurë kjo e mbështetur në nenet 101-104 dhe nenet 109-114 të Rregullores së

³¹⁴ Evidencë 112. Relacion për aktivitetin e Bibliotekës së UAMD

³¹⁵ Evidencë 135. Të dhënat për bibliotekën

³¹⁶ Evidencë 103. Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike

³¹⁷ Evidencë 118. Rregullore e Sekretarisë Mësimore FB

³¹⁸ Evidencë 119. Faqja zyrtare e platformës Pitagora, uamd.pitagora.rash.al

³¹⁹ Evidencë 123. Përdorimi dhe implementimi i Sistemit Pitagora -RASH

³²⁰ Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit

³²¹ Evidencë 95. Rregullore e brendshme e Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Juridike

³²² Evidencë 98. CV të stafit akademik dep FK, bachelor FK

³²³ Evidencë 89. Dosje të vetëvlerësimit të stafit akademik dep FK, bachelor FK

³²⁴ Evidencë 122. Raport Vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore shkencore dhe financiare për v.a. 2021-2022

³²⁵ Evidencë 45. Raport Vetëvlerësimi Fakulteti i Biznesit

³²⁶ Evidencë 125. Orari ndër vite me emra

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	<p>UAMD-së³²⁷, mbështetur gjithashtu në nenin 38, 39, 51-54 dhe neni 56 të rregullores së FB³²⁸, si dhe nenit 31 të rregullores së Departamentit Financë-Kontabilitetit.³²⁹ Sistemi Pitagora³³⁰ ka automatizuar procesin e vlerësimit të studentëve dhe është kthyer në burim të informacionit në kohë reale për lektorin dhe studentin</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Po. Në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës për komunikimin interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve përdoret Pitagora ku hidhen, ruhen, dhe përpunohen të dhëna në lidhje me vlerësimin e studentëve. Lektorë të ndryshëm, në zhvillimin e orëve mësimore, krahas procesit fizik të mësimdhënies, përdorin platformat e google classroom, ose microsoft teams referuar metodave interaktive të mësimdhënies³³¹. Referuar situatës COVID-19, në funksion të komunikimit interaktiv dhe të shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve, stafi akademik i departamentit Financë - Kontabilitet ka zhvilluar leksionet online me programe të certifikuara³³², ku e ka realizuar me sukses mësimdhënien. Një risi dhe inovacion për të gjithë lektorët e departamentit por edhe për të gjithë studentët me të cilët u shkëmbye kjo eksperiencë në kohë pandemie.³³³ Studentët mund të marrin gjithashtu informacione edhe në faqen zyrtare të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës³³⁴, apo rrjete sociale.³³⁵</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Po. Njësia kryesore ka ngritur struktura të cilat mundësojnë monitorimin dhe raportimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrative. Në kriterit 5 të sistemit elektronik specifikohet sesi garantohet monitorimi në kohë reale.³³⁶ Sistemi i menaxhimit të informacionit nuk ekziston i plotë në soft por vetëm në hard-copy. Çdo lektor përpara fillimit të orës mësimore është i detyruar të marrë rregjistrin dhe të firmosë listë-prezencën, e cila shërben si element për kontrollin e pranisë së lektorëve gjatë orës së mësimi. Listëprezenca I dorëzohet ZV. Dekanit të Anës Mësimore I cili njofton Drejtuesit e Njesisë Bazë për problematika. Gjithashtu në përfundim të çdo ore mësimore çdo lektor është i detyruar të dorëzojë në sekretari rregjistrin duke përfunduar me sukses orën mësimore dhe duke ju përmbajtur orarit mësimor sipas Nenit 60, 63 dhe 65 të rregullores së UAMD-së , sipas nenit 38, 39, 51-54 dhe neni 56 të Rregullores së Fakultetit të Biznesit .^{337 338}Në raste mungesash, ose mos zhvillimit të orës mësimore për arsye të ndryshme, lektorët janë të detyruar të njoftojnë Drejtuesin e njësisë bazë dhe ZV. Dekanin e Anës Mësimore sipas nenit 55 të Rregullores së Fakultetit të Biznesit dhe nenit 64 të Rregullores së UAMD-së, duke dhënë informacion të detajuar për zëvendësimin e orës mësimore. Sekretaria e mbikëqyrur nga Zv. Dekani I Anës Mësimore mbikëqyr procesin e dorëzimit të procesverbaleve nga ana e lektorëve dhe raporton problematikat e te Departamentet prekatëse. Orari Mësimor hartohet nga Zv. Dekani i Anës Mësimore dhe I kalohet Drejtuesit të NJB të cilët kordinojnë ndarje e seksioneve me stafin akademik PAE dhe PAK. Studentët dhe palë të interesuar kanë akses ndaj adresave të emailit stafit të interesuar në kohë reale nëpërmjet rrjeteve sociale, website UAMD. Gjithashtu në çdo syllabus secili lector vendos edhe të dhënat personale, nr kontakti, adresë e-maili, nr zyre, në mënyrë që studentët të kenë mundësi ti kontaktojnë.</p>

³²⁷ Evidencë 8. Rregullore e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës

³²⁸ Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit

³²⁹ Evidencë 32. Rregullore e programit të studimit Bachelor “Financë Kontabilitet”

³³⁰ Evidencë 123. Përdorimi dhe implementimi i Sistemit Pitagora -RASHI

³³¹ Evidencë 34. Metodrat interaktive të përdorura për mesimdhënie përfundimtare _shkurt 2023

³³² Evidencë 128. Relacion për zhvillimin e mësimi online 2020-2021

³³³ Evidencë 23. Plani strategjik i Departamentit Financë Kontabilitetit 2021-2025, fq.7.

³³⁴ Evidencë 129. Faqet e rrjeteve sociale facebook të universitetit

<https://www.facebook.com/profile.php?id=100045245540366>

<https://www.facebook.com/NeJemiUAMD>

³³⁵ Evidencë 130. Faqja zyrtare e UAMD-së <https://uamd.edu.al>

³³⁶ Evidencë 123. Përdorimi dhe implementimi i Sistemit Pitagora -RASHI

³³⁷ Evidencë 8. Rregullore e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës

³³⁸ Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Po. Të gjitha informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik si edhe në lidhje me aktivitetet të ndryshme apo njoftime janë të disponueshme në faqen e internet www.uamd.edu.al në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze si dhe në të gjitha rrjete sociale të Dep. FK facebook ³³⁹ , intagram, Alumni Network FB ³⁴⁰			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Po. Bazuar Ligjit nr. 80/2015 ³⁴¹ , Ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” ³⁴² , Ligjin nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020” ³⁴³ , Ligjin nr.7703/1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM-të përkatëse lidhur me çështjet financiare të arsimit në Shqipëri. Struktura buxhetit për UAMD përfshin një pjesë të veçantë që i referohet Departamentit të Financë Kontabilitetit ³⁴⁴ i cili përmban numrin e studentëve për çdo cikël studimi, numrin e pedagogëve dhe ngarkesën e tyre mësimore, orët shtesë, shpenzime korente, shpenzime për kërkim shkencor etj. është në përputhje me strukturën buxhetore të Buxhetit të Shtetit, të përcaktuar me udhëzimet e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë. Programi për mbështetjen financiare hartohet nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në UAMD, i cili përllogarit koston e mbulimit të një cikli të plotë studimi ³⁴⁵ , për çdo student në të gjitha ciklet e studimeve në institucion. ³⁴⁶ Gjithashtu përfshin edhe tarifën dhe pagesat studentore ³⁴⁷ .
